



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**



**KURRIKULA PËR SHKOLLAT ME DREJTIM  
TË ORIENTUAR GJUHËT E HUAJA**

**ARSIMI I MESËM I LARTË**

**DEGA: GJUHËT E HUAJA**

**LËNDA: GJUHË E HUAJ E PARË**

**KLASA: XII**

Tiranë, 2018

## **PËRMBAJTJA E PROGRAMIT LËNDOR GJUHË E HUAJ E PARË**

### **(klasa XII-arsimi i mesëm i orientuar-gjuhët e huaja)**

1	HYRJE .....	3
2	KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT LËNDOR GJUHË E HUAJ E PARË.....	5
2.1	Qëllimet e programit lëndor Gjuhë e huaj e parë .....	8
2.2	Lidhja e kompetencave kyçë me kompetencat e lëndës Gjuhë e huaj e parë.....	10
2.3	Rezultatet e të nxënësit të kompetencave kyçë që realizohen nëpërmjet lëndës Gjuhë e huaj e parë.....	14
2.4	Lidhja e lëndës Gjuhë e huaj e parë me temat ndërkurrikulare.....	21
2.5	Lidhja e lëndës Gjuhë e huaj e parë me fushat e tjera kurrikulare .....	22
2.6	Kompetencat e lëndës Gjuhë e huaj e parë .....	26
2.7	Rezultatet e të nxënësit .....	28
2.8	Ndarja e orëve mësimore.....	38
3	UDHËZIME METODOLOGJIKE.....	40
4	UDHËZIME PËR VLERËSIMIN.....	42

## 1 HYRJE

Lënda Gjuhë e huaj e parë (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, etj.) synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësit. Më konkretisht, lënda Gjuhë e huaj e parë, e aftëson nxënësin në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tij personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të botës së punës.

Mësimi i gjuhës amtare, i letërsisë dhe i gjuhëve të huaja e ndihmon nxënësin të bëhet individ i pavarur, i lirë, i kulturuar, mendimtar kritik dhe krijues, si dhe i vetëdijshëm për identitetin e tij personal dhe kombëtar. Me anë të leximit të teksteve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore (në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të huaj), nxënësi zhvillon botën e tij emocionale, pasuron përfytyrimet dhe imaginatën e tij për botën, çmon dhe vlerëson gjuhët dhe kulturën kombëtare e botërore.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi nxit dëshirën, kuriozitetin dhe besimin e nxënësit për t'u bërë komunikues i mirë, lexues aktiv e i pavarur dhe shkrues i saktë, original dhe krijues.

Lënda Gjuhë e huaj përbëhet nga Gjuhë e huaj e parë dhe Gjuhë e huaj e dytë.

**Gjuha e huaj e parë** fillon në shkallën e dytë (klasa III) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).

**Gjuha e huaj e dytë** fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa VI) dhe vazhdon deri në shkallën e gjashtë (klasa XII). Si gjuhë e huaj e dytë mund të jetë: gjuha frënge, gjuha italiane, gjuha gjermane, gjuha angleze.

Në shkollat me drejtim të orientuar (gjuhët e huaja), nxënësit i jepet mundësi të zgjedhë midis gjuhës së huaj nivel i avancuar ose gjuhës së huaj të tretë nga klasa X deri në klasën XII.

**Kompetencat** përcaktohen si njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime që nxënësi duhet t'i fitojë gjatë procesit mësimor.

**Njohuri** është një e vërtetë e arsyetuar dhe e provuar sipas kritereve të përcaktuara, e kodifikuar në tekstet akademike e ato shkollore apo në vepra të specializuara si produkt i një ose disa dijetarëve apo prakticienëve, ndërtim mendor i realizuar nga personi gjatë bashkëveprimit me mjedisin ose nga vetëreflektimi për t'u bërë pjesë e trashëgimisë njohëse të tij, si p.sh., njohuri për llojet e teksteve, njohuri gramatikore, njohuri për hartimin e një prezantimi, etj..

**Shkathësi** është një kapacitet (mendor/fizik) i fituar për të arritur rezultatet e parashikuara, shpesh me shpenzim minimal të kohës dhe energjisë, ose të të dyjave bashkë. Shkathësia mund të jetë e përgjithshme ose e veçantë, si: të kuptuarit, të interpretuarit, të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese, zgjidhja e problemeve, etj..

**Qëndrimet** janë një mënyrë e përcaktuar e të menduarit, opinioneve dhe ndjenjave ndaj diçkaje, një ideje, personi ose situate dhe që ndikojnë në sjelljen e individit. Qëndrimet ndikohen nga njojuritë dhe vlerat dhe janë zakonisht shkaktare të sjelljeve (edhe pse lidhjet mes qëndrimeve dhe sjelljeve nuk janë drejtvizore).

**Vlerat** janë bindje që ruhen thellë lidhur me çfarë është e rëndësishme ose e dëshirueshme. Ato shprehen nëpërmjet qëndrimeve dhe veprimeve praktike të personave. Disa vlera dhe qëndrime janë respektimi i rregullave të etikës gjatë të folurit, shmangia e fyerjeve dhe paragjykimeve, shpirti i iniciativës, serioziteti, vetëbesimi, etj..

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të lëndës ka nisur që në arsimin bazë. Në këtë nivel arsimi nxënësi është pajisur me njojuritë, shkathësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për jetën, shoqërinë dhe për botën e punës. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësi has sfida të reja dhe përdor aftësitë gjuhësore të fituara gjatë shkollimit për të reaguar në situata të njoitura dhe jo të njoitura për të si në klasë/shkollë ashtu edhe dhe jashtë saj duke mbajtur qëndrime dhe zhvilluar vlera.

## **2 KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT LËNDOR GJUHË E HUAJ E PARË**

Hartimi i programit lëndor mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit të mesëm të orientuar (gjuhët e huaja).

Programi shoqërohet me udhëzues dhe dokumente të tjera në ndihmë të mësuesve dhe të hartuesve të teksteve mësimore.

Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

**Mësuesit** do ta përdorin programin e gjuhës së huaj për të krijuar një tablo të qartë rrith asaj se çfarë duhet të nxërë nxënësi dhe se si duhet të ndërtojnë mësimdhënien për të pajisur nxënësin me kompetencat kyçe dhe ato të lëndës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit. Ky program i ndihmon mësuesit të reflektojnë mbi praktikat e tyre të mësimdhënies dhe të koordinojnë punën dhe përpjekjet e tyre për të përmbushur nevojat e nxënësit në të kuptuarin e lëndës dhe përdorimin praktik të saj edhe jashtë ambienteve shkolllore, pasi mësuesit janë modele të cilat nxënësi ndjek në të ardhmen. Mësuesit do ta përdorin këtë program për të përcaktuar e monitoruar objektivat e vendosura për t'u përmbushur nga nxënësi në klasë, në shkollë si edhe në një raport më të gjërë.

**Autorët e teksteve** do ta përdorin programin lëndor për të hartuar tekste që janë në funksion të realizimit të tij. Leximi i kujdeshëm i programit për çdo shkallë dhe klasë do t'i ndihmojë ata për të siguruar koherencën dhe për të shmangur ngarkesën e panevojshme.

**Specialistët e arsimit** mund ta përdorin programin lëndor për qëllime inspektimi, monitorimi, vlerësimi, studimi, etj.. Vlerësuesit e sistemit arsimor do të mbështeten në këtë program për të parë përmbushjen e standardeve lëndore të përcaktuara për këtë klasë.

**Fakultetet e mësuesisë** mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Përfituesit e programit janë: nxënësit, prindërit dhe komuniteti.

**Nxënësi** përfiton të nxënët progresiv, zbaton shprehitë njojuritë, veprimtaritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndën përkatëse dhe bëhet përdorues i mirë i gjuhës.

**Prindërit dhe komuniteti** mund të informohen për kompetencat që duhet të zoterojnë fëmijët e tyre në lëndën e gjuhës së huaj.

Programi lëndor Gjuhë e huaj e parë ka në fokus realizimin e kompetencave kyçë dhe të kompetencave të lëndës. Gjatë punës për përbushjen e kompetencave kyçë dhe kompetencave të lëndës, nëpërmjet gjuhës së huaj do të realizohen temat ndërkurrikulare, të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe botën e punës. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës së huaj me fushat e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor dhe t'i shërbejë formimit të tij të gjithanshëm.


Realizimi i programit në lëndën e gjuhës së huaj mundëson krijimin e një mjedisi të nxëni të përshtatshëm, inkurajues, motivues, gjithëpërfshirës dhe të pasur me material të domosdoshme burimore duke përdorur sa më gjerë dhe në mënyrë efektive TIK.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës si edhe për çdo veprimtari, aftësi dhe shkathtësi gjuhësore që kryen nxënësi për formimin dhe konsolidimin e kompetencave.

Gjithashtu programi i jep mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe inovativ në punën e tij duke përdorur metodat, strategjitë dhe përqasjet më bashkëkohore në procesin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit. Po kështu, në program janë sugjeruar edhe orët mësimore në përqindje për njohuritë që do merren gjatë vitit shkollor.

Diagrami i mëposhtëm paraqet se si programi i gjuhës së huaj është pjesë integrale e Kornizës Kurrikulare e cila synon një mësimdhënie me në qendër nxënësin, zhvillimin dhe përgatitjen e tij për t'u bërë anëtar i shoqërisë së dijes.

**Diagrami 1:** Korniza Konceptuale e Programit Lëndor “Gjuhë e huaj



## **2.1 Qëllimet e programit lëndor Gjuhë e huaj e parë**

Lënda e gjuhës së huaj në arsimin e mesëm të lartë ka si qëllim që nxënësi:

- të ndërgjegjësohet për aspektet kulturore dhe të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendit ku flitet gjuha e huaj dhe kulturës amtare duke analizuar aspekte të kulturës që studion siç janë institucionet shoqërore dhe politike;
- të zhvillojë më tej aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike të jetës së përditshme, për të hulumtuar dhe dhënë përgjigje e argumente për çështje të interesit të tij;
- të respektojë traditat dhe vlerat e kulturave të ndryshme;
- të forcojë ndërveprimin në situata reale dhe jashtëshkollore, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe të shkëmbëjë informacione të detajuara mbi tema që paraqesin interes për të;
- të konsolidojë bashkëveprimin ndërmjet punës në grup dhe punës së pavarur individuale dhe krijuese edhe me folës të gjuhës të cilën ai mëson;
- të thellojë njohuritë gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave ai zgjeron njohuritë për botën dhe në të njëjtën kohë formohet intelektualisht;
- të zhvillojë rrjedhshmërinë në gjuhën e huaj përmes praktikës së vazhdueshme të përshtatshme për moshën, interesat dhe nivelin e tij gjuhësor.

Programi lëndor Gjuhë e huaj e parë për klasën XII për shkollat me drejtim të orientuar- gjuhët e huaja, i hartuar në përputhje me Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar (viti 2000), si dhe në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER), synon të arrijë dhe të realizojë standarde mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit me qëllim që t'i

përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimit dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë. Ky program përfshin njohuritë gjuhësore, ndërlendore dhe ndërkulturore të përfituarë ndër vite.

Lënda e gjuhës së huaj ka përmision aftësimin dhe orientimin e nxënësit për të vepruar në situata të ndryshme komunikimi gjuhën që po mëson. Ajo ka përdetyrë të zhvillojë te nxënësi aftësitë e gjuhës gjatë përdorimit të saj dhe ta edukojë atë me të kuptuarin, pranimin dhe vlerësimin e kulturës dhe mënyrës së jetesës së popujve të tjera. Programi hartohet mbi interesat dhe karakteristikat e grupmoshës dhe ndihmon në zhvillimin intelektual dhe socio-kulturor të nxënësit duke e bërë atë të pavarur dhe të aftë të përballojë të nxënët gjatë gjithë jetës. Nxënësi, gjithashtu, mëson dhe bindet se gjuha e huaj, si një subjekt aftësish dhe komunikimi, kërkon kohë dhe praktika të shumëllojshme komunikimi për t'u përvetësuar. Si lëndë akademike, gjuha e huaj është një lëndë kulturash dhe aftësish.

Niveli gjuhësor i nxënësit në gjuhën e huaj të parë, në klasën e XII të shkollave me drejtim të orientuar-gjuhë të huaj, bazohet mbi njohuritë dhe konceptet e marra në klasat paraardhëse si dhe në konsolidimin e mëtejshëm të kompetencave kyçë dhe ato të lëndës përkëtë shkallë. Nxënësi në këtë klasë forcon aftësinë e tij të qenit i pavarur në përdorimin e gjuhës së huaj. Niveli gjuhësor i synuar është B 2 +.

Më poshtë jepet përshkrimi i nivilit B 2 i cili i referohen shkallës globale të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët.

<b>Përdorues i pavarur</b>	<b>B2</b>	<p>Mund të kuptojë idetë kryesore të një teksti kompleks mbi çështje konkrete dhe abstrakte duke përfshirë diskutime teknike në fushën e tij/saj të specializimit.</p> <p>Mund të bashkëveprojë rrjedhshëm dhe spontanisht me folës vendas të mundshëm pa vështirësi përbashkëfolësin.</p> <p>Mund të prodhojë një tekst të qartë, të detajuar rreth një sërë temash dhe shpjegojë pikëpamjet e tij/saj për një çështje të ditës, duke dhënë avantazhe dhe dizavantazhe për opsione të ndryshme.</p>
----------------------------	-----------	--

Në nivelin B2+ fokusi është tek argumentimi dhe prezantimi efektiv i ideve. Kjo shkallë e re e kompetencës komunikative vihet re jo vetëm kur nxënësi menaxhon në mënyre efektive një diskutim duke ndihmuar bashkëfolësin në vazhdimësinë e bashkëbisedimit por edhe në përdorimin e strategjive për të argumentuar në mënyrë sistematike dhe të logjikshme. Në këtë nivel nxënësi gjithashtu arrin të bëjë negociata, të bindë bashkëfolësin si edhe të përmbledhë një çështje në mënyrë koherente.

## **2.2 Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës Gjuhë e huaj e parë**

Realizimi i kompetencave kyçe të Kornizës Kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat e fushës dhe të lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetencë dhe rezultati të të nxënitet. *Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.* Kur nxënësi përbush kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë prezantimeve të ndryshme në orët mësimore të kompetencës së folurit për të komunikuar dhe për të mësuar, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe realizon kështu edhe kompetencën digitale. Rezultatet e të nxënitet të kompetencave të fushës ku bën pjesë lënda e gjuhës së huaj, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënitet të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, shoqëri dhe punë.

Gjithashtu e parë në kontekstin e anasjelltë nxënësi ndihmohet nga kompetencat kyçe për të përbushur sa më mirë kompetencat specifike të lëndës dhe për të realizuar veprimtaritë gjuhësore. Si p.sh kur nxënësi lexon një tekst ai nuk bazohet vetëm tek kompetenca gjuhësore por edhe tek kompetenca e të menduarit ose ajo qytetare bazuar në llojin e tekstit që lexon, ose nëse nxënësi lexon një tekst si pjesë e një programi të të mësuarit ai bazohet te kompetenca e të mësuarit për të nxënë.

Një tjetër shembull do të ishte edhe zhvillimi i një projekti gjatë orës mësimore. Nëse nxënësi bën një projekt si temë mësimore në këtë rast ai jo vetëm zhvillon kompetencat e tij gjuhësore, por gjithashtu kompetencat digitale dhe qytetare, në varësi të tematikës që ai shtjellon.

Përzasja e adoptuat nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët (KPER) është e orientuar drejt veprimit pasi përdoruesi i gjuhës ose nxënësi konsiderohet si “aktor shoqëror” d.m.th. pjesëtar i shoqërisë i cili ka detyra për të përmbushur (të cilat nuk janë vetëm gjuhësore) në rrithana dhe në një mëjdis të caktuar dhe brenda një fushe të caktuar veprimi. Komunikimi realizohet nëpërmjet aktiviteteve gjuhësore të cilat janë pjesë e një konteksti më të gjerë shoqëror që ju jep atyre kuptim të plotë. Përzasja vepruese merr gjithashtu parasysh burimet njohëse, emocionale, të vullnetshme si edhe tërësinë e aftësive që zotëron dhe vë në jetë çdo individ si një aktor shoqëror.

Në bazë të kësaj përzasjeje çdo formë përdorimi dhe nxënjeje e një gjuhe mund të përkufizohet si më poshtë.

Përdorimi i një gjuhe, duke përfshirë edhe nxënien e saj, përfshin veprime të kryera nga njerëzit, të cilët si individë dhe si aktorë shoqërorë zhvillojnë një numër kompetencash kyçë dhe në veçanti kompetencën e komunikimit gjuhësor. Nxënësi vë në zbatim kompetencat që zotëron në kontekste dhe kushte të ndryshme dhe kalon vështirësitë për t'u përfshirë në veprimtari gjuhësore të cilat përfshijnë proceset gjuhësore që mundësojnë kuptimin dhe prodhimin e teksteve që lidhen me temë dhe fusha specifike duke mobilizuar strategjitet më të përshtatshme për përmbushjen e detyrave që duhen realizuar. Monitorimi i këtyre veprimeve nga vetë nxënësi çon në përforcimin ose përmirësimin e kompetencave. Kjo përzasje illostrohet në figurën e mëposhtme.




*Figura 1: Të mësuarit dhe përdorimi i gjuhës së huaj*

Kompetencat kyçe nuk lidhen vetëm me gjuhën por kanë të bëjnë me çdo lloj veprimtarie duke përfshirë edhe ato gjuhësoret.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënит për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënит për kompetencat specifike të lëndës që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse;
- përshtat rezultatin/et e të nxënит për çdo fushë veprimtarie dhe mënyre të marrjes së gjuhës (me shkrim dhe me gojë): **marrja e informacionit** (të lexuarit, të dëgjuarit), **ndërveprimi** (të folurit ndërveprues, të shkruarit ndërveprues), **produkti** (produkti i të folurit, produkti i të shkruarit) dhe **ndërhyrja** (përbledhja, interpretimi, perifrazimi, përkthimi, etj.);
- përzgjedh përbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënitet;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënitet brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënitet për vit mësimor dhe shkallë për fushën Gjuhët dhe komunikimi.

Diagrami i mëposhtëm konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës të cilat së bashku i ofrojnë nxënësit informacionin në mënyrë efikase dhe bëjnë që nxënësi të përforcojë hap pas hapi arritjet e tij për të lexuar, shkruar dhe komunikuar duke i bërë funksionale dhe të qëndrueshme aspekte të ndryshme të informacionit, kulturës, shkencës dhe teknologjisë.



*Diagrami 2:Lidhja e kompetencave kyçë me kompetencat e lëndës Gjuhë e huaj*

## 2.3 Rezultatet e të nxënësit të kompetencave kyçë që realizohen nëpërmjet lëndës Gjuhë e huaj e parë

<i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</i>
<b>Nxënësi:</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>shpreh para një audience të caktuar, çështjet thelbësore të ngritura në një fjalim ose në një interpretim për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme, përmes së paku një forme komunikimi (gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, performancës artistike, etj.);</li><li>diskuton në grup, në mënyrë konstruktive duke dhënë informacion, argumente dhe duke shtruar pyetje në një dialog prej disa minutash, për një temë të caktuar në gjuhën amtare ose në një gjuhë të huaj;</li><li>lexon rrjedhshëm një tekst të panjohur në gjuhën e huaj, i cili përbën 2-3 faqe (tregim letrar, artikull gazete ose reviste etj.), identifikon ngjashmëritë dhe dallimet kryesore në strukturën e fjalive në gjuhën e huaj dhe në gjuhën amtare, duke nën vizuar dhe duke e ilustruar me shembuj konkretë;</li><li>përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj, në një numër të caktuar kontekstesh, si: ese, e-mail, letra formale dhe joformale, etj.;</li><li>lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej disa paragrafësh dhe shprehet në forma të ndryshme të komunikimit për organizimin, qëllimin, leksikun e përdorur, si dhe argumenton mesazhin që mbart secili paragraf (teksti mund të jetë narrativ, përshkruar, artistik, etj.);</li><li>rezanton një temë të caktuar nga arti, nga shkenca, ngajeta e përditshme dhe në mënyrë efektive komunikon me audiencën, duke përdorur TIK-un dhe mediet e tjera të shkruara dhe elektronike;</li><li>shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin e tij për një temë të caktuar ngajeta, nga shkenca, nga profesioni, nga shoqëria, nga mjediseti, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit, me gojë ose me shkrim;</li></ul>

- angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar p.sh., për edukimin mediatik, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte, për rolin dhe ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë;
- përdor në mënyrë efektive, programet e TIK-ut gjatë procesit të nxënës (duke përfshirë edhe nxënësit në distancë) si dhe gjatë kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore.

### ***Kompetenca e të menduarit***

#### **Nxënësi:**

- sqaron ecurinë e zgjidhjes së një problemi në klasë apo jashtë saj, duke e vërtetuar zgjidhjen e problemit përmes metodës së analizës dhe e prezanton para moshatarëve ose para të tjerëve;
- analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për një temë ose detyrë të dhënë, vlerëson cilësinë e tyre dhe i radhit ato sipas rëndësisë dhe qëllimit që kanë (temat mund të janë, p.sh., orientimi në karrierë, integrimi evropian, ndryshimet klimatike, rreziku nga armët konvencionale, armatimi bërthamor, zhvillimi kulturor-artistik në vend, etj.);
- gjykon rezultatet e arritura, nga analiza e të dhënave të një projekti apo programi të realizuar dhe i interpreton ato me gjuhën e matematikës dhe të fushës përkatëse, i paraqet grafikisht, në formë tabellore, duke nxjerrë përfundime të vërtetuara (p.sh., projekt me bazë shkolle, projekt për gjelbërimin, koncert, ekspozitë tematike, orë letrare, punë laboratorike, etj.);
- hulumton në mënyrë të pavarur për një çështje të caktuar, duke përcaktuar fazat dhe procedurat e hulumtimit, paraqet dhe interpreton rezultatet e fituara në tabela dhe grafikë, duke përdorur teknologjinë informative;
- identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrën e duhur për të zgjidhur një problem në nivelin e caktuar të vështirësisë, duke dhënë shembuj konkretë;

- vlerëson cilësinë e informacioneve në një material të shkruar për një temë të caktuar (p.sh., për ngrohjen globale, për diversitetin kulturor dhe etnik etj.), identifikon elementet kryesore, i diskuton me moshatarët, duke dhënë propozime konkrete për shfrytëzimin e shembujve pozitivë në kontekstin lokal apo global, duke shprehur qëndrimin personal;
- përpunon në mënyrë kritike, informacionet e mbledhura nga burime të ndryshme për ndonjë temë të ndjeshme në shoqëri, formon qëndrim kritik dhe e paraqet atë gjatë një debati me moshatarët dhe me të tjerët për çështjen e ngritur, “pro” ose “kundër” (martesat mes anëtarëve të një gjинie, dënim me vdekje, etj.);
- argumenton rezultatet e arritura gjatë një eksperimentimi në shkollë apo diku tjetër, duke pëershruar qëllimin, hipotezën dhe mënyrën e vëzhgimit të dukurisë së manifestuar, rezultatet i paraqet në mënyrë tabelore dhe grafike;
- zbaton njohuritë dhe përvojën në kontekst të zgjidhjes së një problemi nëpërmjet veprimeve të përshtatshme, p.sh., përfshin të rindjtë në një debat për tema me interes shkencor, shoqëror, historik, kombëtar etj., vetëm pasi të jenë bërë përgatitjet e duhura dhe të jetë bërë informimi i të gjithëve.

### *Kompetenca e të nxënít*

#### **Nxënësi:**

- demonstron shkathësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përbushjen e kërkësave të ndryshme gjatë të nxënít (p.sh., për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për vizatimin e një plani të shtëpisë, apo për përgatitjen e shkresave dhe të prezantimeve, etj.);
- diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore (ose një problem nga jeta e përditshme ose për të menaxhuar konfliktet me bashkëmoshatarët), tregon mënyrën e shfrytëzimit të përvojave paraprake për të zhvilluar njohuritë dhe shkathësitë e reja në zgjidhjen e situatave dhe problemeve të tillë;
- shfrytëzon, në mënyrë të duhur, këshillat dhe informacionet e marra për përkrahje në zgjidhjen e një detyre apo problemi të caktuar, pastaj rezultatet i paraqet para të tjerëve;

- bën përpunimin e informacioneve për një temë të caktuar në mënyrë të pavarur dhe efektive, rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit;
- paraqet një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi, etj.) për ndonjë çështje të caktuar (p.sh., vlerat kulturore të rajonit të vet, vlerat e edukimit në shoqëri, etj.) duke respektuar të gjithë hapat e planit të studimit dhe e paraqet para të tjerëve;
- shkruan një letër motivuese në të cilën arsyeton angazhimin e vet për pjesëmarrje në një prezantim ose konkurs nga një fushë e caktuar mësimore, duke vënë theksin në aftësitë dhe cilësitë personale;
- përzgjedh punimet kryesore të dosjes së vet për të shpjeguar para një audience të caktuar strategjitet që ka zbatuar për të ndjekur avancimin e vet dhe masat e zbatuara për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme;
- vlerëson, në mënyrë kritike, punën e vet duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës p.sh., në mënyrë të pavarur redakton një dorëshkrim të tij për përmirësimin e organizimit të shkrimit, e qartësisë së mendimit, etj.;
- menaxhon në mënyrë produktive, burimet që ka në dispozicion (kohën, njerëzit, mjetet e punës etj.) gjatë kryerjes së një aktiviteti ose detyre të caktuar në një fushë mësimore apo në situata të jetës së përditshme.

### ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin***

#### **Nxënësi:**

- përcakton prioritete, jep zgjidhje cilësore për përmirësimin e mjedisit, si dhe zbaton parimet e tregut të lirë dhe të buxhetimit në situata të jetës reale;
- ndërmerr iniciativë në aktivitete të ndryshme me interes për lëndën/fushën mësimore, për klasën, për shkollën dhe për mjedisin ku jeton, si dhe tregohet i përgjegjshëm në plotësimin e detyrave, përbushjen e detyrimeve dhe respektimin e afateve, referuar projektit apo planit;
- argumenton me shembuj konkretnë lidhjet midis punës, profesionit dhe karrierës, prezanton vendimmarjen personale referuar mundësive në dispozicion për arsimim/ trajnim të mëtejshëm, mundësive personale dhe financiare, si dhe argumenton zgjidhjet për realizimin e planit personal të karrierës;

- planifikon dhe menaxhon me sukses një projekt me objektiva të caktuara, si p.sh., një projekt për organizimin e ndërmarrjeve të vogla që ofrojnë produkte dhe shërbime për qytetarët, duke u mbështetur në kërkesat aktuale të tregut të punës;
- paraqet modelin e një drejtuesi të një ndërmarrjeje ose organizate, sipas imaginatës personale dhe duke respektuar karakteristikat kryesore të një sipërmarrësi të suksesshëm;
- përdor aftësitë digitale për llogaritjen, analizën, interpretimin dhe paraqitjen e të dhënave me informacione të nevojshme (p.sh., të një mjeshtërisë së biznesit), duke renditur të dhënat sipas nevojave dhe prioriteteve të ndërmarrjes ose organizatës;
- zbaton udhëzimet dhe rregullat e shkruara në udhëzues, katalog, apo skicë për përdorimin e drejtë të mjeteve laboratorike, makinave dhe pajisjeve teknike, gjatë një ushtrimi ose aktiviteti (në klasë, në laborator, etj.), si dhe tregon për të tjerët mënyrën e zgjedhjes dhe përdorimit të tyre;
- paraqet kompetencat e nevojshme për të përballuar situata të ndryshme jetësore apo për zhvillimin e karrierës në një fushë të caktuar;
- merr iniciativa të suksesshme për organizimin e aktiviteteve të ndryshme që nxisin bashkëpunimin e ndërmarrjeve me komunitetin, duke promovuar interesin e dyanshëm.

#### *Kompetenca personale*

##### **Nxënësi:**

- demonstron vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale në jetën e përditshme, duke dalluar aspektet pozitive për veten dhe duke ndërmarrë veprime konkrete për arritjen e rezultateve të synuara personale;
- tregon shkathtësi në organizimin e lojës me të tjerët, garave sportive apo aktiviteteve kulturore dhe menaxhon me sukses emocionet e veta në situata të ndryshme gjatë aktiviteteve dhe gjatë jetës së përditshme;
- shfaq në forma të ndryshme, empati për të tjerët, p.sh., merr pjesë në aktivitete bamirësie, ndihmon të mos huarit, të sëmurët etj., dhe përvojat e tilla i prezanton para të tjerëve;

- paraqet, me gojë ose me shkrim, përparësitë e aktiviteteve fizike ditore për individin e shëndoshë dhe prezanton para të tjerëve qëllimet e vendosura për veten në këtë fushë (për aktivitetet fizike ditore) dhe nivelin e arritjes së tyre;
- zgjidh konfliktet ndërpersionale në mënyrë konstruktive, duke shqyrtau alternativat, duke marrë vendime dhe duke shpjeguar zgjedhjet e bëra;
- bën zgjedhje dhe merr vendime të duhura lidhur me shëndetin, dietat dhe ushtrimet në jetën e përditshme ose në situata dhe aktivitete mësimore;
- shfaq në forma të ndryshme, ndërgjegjësim për menaxhimin e emocioneve, stresit dhe konflikteve në situata të jetës së përditshme apo në situata të improvizuara me karaktere të ndryshme historike, aktuale, sociale, etj.;
- prezanton në forma të ndryshme shprehëse, mënyrën e zbatimit të planeve personale të jetës (p.sh., në shkollim, në karrierë, në sport, në shoqëri, në biznes etj.), vlerëson nivelin e arritjeve të qëllimeve të synuara dhe ilustron shembuj të veçantë të planeve personale për të ardhmen;
- shpreh në forma të ndryshme, qëndrimin e vet të pavarur për përgjegjësinë e të qenit prind/kujdestar, planifikimin e familjes dhe merr vendime të drejta për të ardhmen e tij.

#### *Kompetenca qytetare*

#### **Nxënësi:**

- prezanton mënyrën e funksionimit të mjedisit shoqëror në nivel lokal dhe me gjerë, si dhe me shembuj konkretë tregon kontributin e vet në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të mjedisit;
- harton një listë propozimesh për zbatimin e të drejtave themelore të njeriut në një situatë të caktuar, i kategorizon propozimet sipas rëndësisë dhe urgjencës, duke veçuar argumentet kryesore që mbështesin qëndrimin e vet;
- prezanton në forma të ndryshme, se si i ushtron të drejtat e veta në shkollë dhe në jetën e përditshme dhe si i njeh e i respekton të drejtat e të tjerëve, duke dhënë shembuj konkretë;

- paraqet në forma të ndryshme të të shprehurit, vlerat kryesore të diversitetit në shoqëri apo në mjedisin ku jeton, i diskuton ato me të tjerët, duke i krahasuar me shembuj nga jeta e përditshme që tregojnë tolerance, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve;
- ilustron me shembuj nga jeta e përditshme, praktikat e menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve në mënyrë konstruktive, duke ndarë me të tjerët përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta gjatë diskutimeve të shembujve ilustrues në këtë fushë;
- merr pjesë në proceset demokratike të vendimmarries në nivele të ndryshme (në familje, në shkollë, në komunitet, etj.), i diskuton me të tjerët përvojat personale dhe paraqet propozime të argumentuara se si të përmirësohet pjesëmarrja demokratike dhe vendimmarria në shoqëri;
- prezanton në një debat me të tjerët ose në një formë tjeter të të shprehurit, masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave dhe parimeve të të drejtave të njeriut në jetën e përditshme, duke veçuar shembuj konkretë të ndonjë aktiviteti (p.sh., aktivitete për promovimin e barazisë gjinore, shmangien ndaj paragjykimeve dhe diskriminimit, luftën ndaj varfërisë, etj.);
- ilustron me shembuj, zgjidhjen e problemeve të caktuara në nivel shkolle ose në nivel komuniteti, si dhe e arsyeton atë me argumente para një audience të caktuar (p.sh., demonstron mënyrën e ofrimit të ndihmës së parë në rastet e fatkeqësive natyrore ose njerëzore);
- merr pjesë në përgatitjen dhe në organizimin e një aktiviteti (në shkollë apo në komunitet) për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu dhe në mënyra të ndryshme kontribuon për zhvillimin e qëndrueshëm të tij;
- ndërmerr apo udhëheq një aktivitet për vlerësimin e cilësisë dhe të saktësisë së informacioneve në një faqe *ueb* që shfrytëzohet më shumë nga moshatarët, arsyeton aktivitetin dhe vlerësimin e bërë, ofron këshilla të mbështetura në etikën morale dhe profesionale për shfrytëzimin e përgjegjshëm të internetit.

### *Kompetenca digjитale*

#### **Nxënësi:**

- përdor programet e TIK-ut në mënyrë efektive për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënëtit, duke përfshirë edhe të nxënëtit në distancë;
- prezanton një projekt, duke përdorur sekuenca animimesh, videoesh, figurash për demonstrimin e temave mësimore;

- vlerëson cilësinë e informacionit që gjen nga një shumëlojshmëri burimesh dhe mediesh;
- përdor sistemet e duhura kompjuterike (hardëare, softëare, netëorks dhe softet) si: Ëord Processing, Database, Poëer-Point, Publisher, Internet Explorer për përdorimin e TIK-ut në situata të ndryshme të të nxënësit (ndërtimin e tabelave, grafikëve, diagrameve, vizatimin e një plani, përgatitjen e shkresave dhe të prezantimeve);
- është krijues në zbatimin e njojurive që përmbajnë shkencat kompjuterike dhe mediet digitale;
- tregon rregullat e sigurisë që duhen zbatuar për të ruajtur privatësinë personale sipas kodit të etikës së komunikimit personal dhe në grup;
- është aktiv dhe i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces;
- ndërgjegjësohet mbi globalizmin dhe larminë e kulturave, duke shkëmbyer me nxënësit e vendeve të ndryshme përvojat e vendit tonë.

## 2.4 Lidhja e lëndës Gjuhë e huaj e parë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënësit, të cilat ndihmojnë nxënësin të interpretojë botën dhe të lidhë dijet e marra në shkollë me jetën dhe interesat e tij. Në Kornizën Kurrikulare dhe në Kurrikulen Bërthamë të AML janë përcaktuar temat ndërkurrikulare, të cilat janë:

- Identiteti kombëtar dhe njojja e kulturave
- Të drejtat e njeriut
- Vendimmarrija morale
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Mjedisi
- Ndërvarësia
- Bashkëjetesa paqësore

Gjuha e huaj zhvillon te nxënësi njohjen e vlerësimin e kulturës dhe traditës botërore dhe kultivon identitetin dhe krenarinë kombëtare. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisit, zhvillimi i qëndrueshëm, etj. mund të realizohen gjatë orëve mësimore ku mësuesi mund të krijojë situata të të nxënëtit gjatë të cilave nxënësi shpreh në forma të ndryshme ( ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë çeshtjet e mësipërme) mendimet e tij të pavarura dhe të mbështetura me argumente dhe shembuj nga jeta e përditshme.

Punët në grupe dhe projektet që zhvillohen në lëndën e gjuhës së huaj, ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësit për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët, me natyrën dhe për të promovuar detyrat dhe të drejtat e individit në një shoqëri të lirë dhe demokratike si dhe për të promovuar historinë e kulturën e kombit të tij dhe të vendit gjuhën e të cilit mëson.

## 2.5 Lidhja e lëndës Gjuhë e huaj e parë me fushat e tjera kurrikulare

Programi lëndor Gjuhë e huaj e parë mbështetet në integrimin ndërlëndor. Gjuha e huaj e pajis nxënësin me njohuri, aftësi dhe shkathtësitë që sigurojnë suksesin e tij edhe në fushat dhe lëndët e tjera. Kompetencat gjuhësore janë kompetenca që ndihmojnë nxënësin në procesin e të nxënëtit në të gjitha fushat kurrikulare. Konceptet e njohuritë gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore dhe ligjërimore, të cilat lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës së huaj dhe të trajtuarë në lëndët e tjera.

Nxënësi zgjeron fjalorin dhe zhvillon aftësinë e të shprehurit qartë me shkrim dhe me gojë në fushat e tjera.

Gjuha e huaj mundëson nxënësin që të kuptojë dhe analizojë tekste ose mesazhe të ndryshme. Duke lexuar tekste të fushave të ndryshme (gjeografi, qytetari, etj.) nxënësi zgjeron njohuritë për atë fushë. Leximi dhe analiza e teksteve letrare ndikon në të kuptuarin e ngjarjeve dhe figurave historike si dhe të vlerave shoqërore. Me fushën shoqëria dhe mjedisit janë të lidhura tema si: miqësia, marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet në shkollë, koha e lirë, festat, etj..

Duke përvetësuar aktet dhe funksionet gjuhësore nxënësi mëson si të komunikojnë me të tjerët në mënyrë korrekte dhe gramatikisht të saktë.

Gjithashtu përvetësimi i mirë i gjuhës së huaj ndihmon nxënësin të zhvillojë më tej punën e tij kërkimore në fushat e tij të interesit (histori, shkenca, matematikë, etj.) pasi shumë materiale gjenden në gjuhë të huaj. Integrimi i tij lëndëve të tjera në gjuhën e huaj ndihmon jo vetëm në lidhjen


ndërlendore por edhe në pasurimin e një leksiku më specifik dhe përdorimin e tij. Lidhja me *shkencat natyrore* p.sh. matematikës dhe gjuhës së huaj shprehet në mësimin numrave, veprimeve matematikore (mbledhja e zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi).

Në lëndën e biologjisë, lidhja bëhet e qartë duke trajtuar tema, si: pjesët e trupit, ushqyerja, shëndeti, mjedisi. Me artet janë të lidhura ngushtë temat mbi sportin, muzikën, modën, pikturen, etj.. Lidhja me lëndën e TIK-ut, përmes së cilës nxënësi aftësohet të përdorë internetin, email-in,

programe të ndryshme, platforma digitale, aplikacione etj, ndihmon atë të eksplorojë të rejat mbi botën që po studion, të prezantojë sa më bukur

dhe në mënyrë logjike idetë dhe opinionet e tij dhe të marrë informacion në kohë reale. Më konkretisht, kjo lidhje jepet në diagramin e mëposhtëm.

**Diagrami 3:** Lidhja e lëndës Gjuhë e huaj me fushat e tjera kurrikulare



## 2.6 Kompetencat e lëndës Gjuhë e huaj e parë

**Kompetencat e komunikimit gjuhësor** janë ato të cilat e fuqizojnë një person të veprojë duke përdorur specifisht mjetet dhe mënyrat gjuhësore. Për të realizuar qëllimet komunikuese, nxënësi mobilizon të gjitha kapacitetet e tij dhe i kombinon ato me kompetencën e komunikimit gjuhësor. Kompetenca e komunikimit gjuhësor është një sintezë e njojurive të parimeve bazë gramatikore, e njojurive se si gjuha përdoret në ambiente shoqërore për të kryer funksionin komunikues dhe e njojurive se si funksionet komunikuese kombinohen me parimet e ligjërimit.

### Përshkimi i kompetencave të lëndës

Kompetenca e komunikimit gjuhësor përbëhet nga kompetencat e mëposhtme:

**Kompetenca gjuhësore** nënkupton përvetësimin e rregullave gramatikore, semantike, fonetike, ortografike si dhe pasurimin e fjalorit.

**Kompetenca socio-gjuhësore** ka të bëjë me dimensionin shoqëror të gjuhës dhe i referohet të mësuarit të akteve të ndryshme të ligjërimit dhe komunikimit në kontekste të ndryshme shoqërore. Këto kontekste kanë të bëjnë me statusin shoqëror, gjininë, moshën e nxënësit si dhe me faktorë të tjerë që influencojnë në stilin dhe regjistrat e gjuhës. Zhvillimi i kësaj kompetence është shumë i rëndësishëm pasi në situata të ndryshme duhen përdorur lloje të ndryshme shprehjesh si edhe duhen mbajtur qëndrime, besime, vlera dhe pikëpamje të ndryshme.

**Kompetenca pragmatike** ka të bëjë me njojen e rregullave dhe parimeve sipas te cilave mesazhi komunikues organizohet dhe strukturohet (zhvillimi i temës, lidhja logjike e ideve, koheranca e mendimeve) dhe realizimin e funksioneve komunikuese (kërkimi i informacionit, dhënia e këshillës, kërkimi për ndihmë, rënia dakord, përshëndetjet, etj.).

Dy faktorë cilësorë të cilët përcaktojnë suksesin e nxënësit në realizimin e funksioneve komunikuese janë:

- a. Rrjedhshmëria
- b. Saktësia e të shprehurit


Duke u bazuar tek kompetencat kyçë dhe ato të komunikimit gjuhësor, nxënësi përdor aftësi dhe strategji të përshtatshme për përbushjen e detyrave në veprimtaritë gjuhësore (me shkrim dhe me gojë): marrja e informacionit (të lexuarit, të dëgjuarit), ndërveprimi (të folurit ndërveprues, të shkruarit ndërveprues), produkti (produkti i të folurit, produkti i të shkruarit) dhe ndërhyrja (përmbledhja, interpretimi, perifrazimi, përkthimi

,etj.). Kryerja e vazhdueshme e veprimtarive gjuhësore bën që nxënësi të forcojë aftësitë dhe shkathësitë e **të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit** dhe **të shkruarit**.

Lidhja midis aftësive, shkathësive, veprimtarive dhe kompetencave mund të shihet si një lidhje burimore ku nxënësi gjen tek kompetencat mjetet për të realizuar veprimtaritë, por këto të fundit modifikohen dhe shtohen gjatë procesit të komunikimit. Një numër i kufizuar kompetencash i lejon nxënësit të kryejë një numër shumë të madh veprimtarish. Të kuptuarit e këtij dallimi është thelbësor për të bërë të suksesshëm procesin e të mësuarit dhe të nxënëtit të gjuhëve.

Përdorimi i gjuhës veçanërisht në ndërveprim me të tjerët lejon përvetësimin e gjuhës, e cila në vetvete përfshin zhvillimin e kompetencave. Të mësuarit e pakontekstualizuar të kompetencave (si p.sh. mësimi i rregullave gramatikore) e ndihmon nxënësin, por nuk është i mjaftueshëm për të përdoru gjuhën si një mjet komunikimi.

*Diagrami 4: Lidhja e kompetencave të lëndës Gjuhë e huaj me veprimtaritë, aftësitë dhe shkathësitë gjuhësore*



## 2.7 Rezultatet e të nxënësit

KOMPETENCA	REZULTATET
<b>GJUHËSORE</b>  Nxënësi zotëron gjuhën në mënyrë të tillë që të jetë në gjendje të bëjë përshkrimë të qarta, të shprehë pikëpamje dhe të zhvillojë argumente duke mos pasur vështirësi në gjetjen e fjalëve dhe duke përdorur forma dhe struktura të përbëra fjalish.	<b>Fjalori</b>  Nxënësi zotëron fjalor të pasur për tema të përgjithshme dhe ato që lidhen me fushën e tij të interesit. Nxënësi përdor formulime të ndryshme fjalish për të shmangur përsëritjet por akoma mund të vihen re moment hezitim. Saktësia gjuhësore është në përgjithësi e lartë megjithëse mund të shfaqen moment konfuzioni pa ndikuar komunikimin.
	<b>Saktësia gramatikore</b>  Nxënësi tregon shkallë të lartë kontrolli gramatikor duke mos bërë gabime të cilat mund të çojnë në keqkuptime.
	<b>Fonetika</b>  Nxënësi ka fituar shqiptim dhe intonacion të qartë dhe të natyrshëm.
	<b>Ortografia</b>  Nxënësi shkruan në mënyrë inteligjente tekste të gjatë dhe të qartë duke zbatuar strukturën standarde të organizimit të paragrafëve dhe të gjithë tekstit. Drejtshkrimi dhe pikëzimi janë të saktë por mund të ketë shenja të influencës së gjuhës amtare.
<b>SOCIO-GJUHËSORE</b>	<b>Aktet e ligjërimit dhe komunikimit</b>  Nxënësi me pak përpjekje merr pjesë dhe vazhdon një diskutim në grup edhe kur flitet shpejt dhe me shprehje idiomatike. Nxënësi gjithashtu diskuton me një folës vendas të asaj gjuhe duke mos shkaktuar keqkuptime dhe duke u shprehur në mënyrë të përshtatshme dhe pa gabime në formulimin e ideve.
<b>PRAGMATIKE</b>	<b>Fleksibiliteti</b>  Nxënësi përshtatet kur në diskutim ndryshohet tema dhe stili duke ndryshuar formulimet sipas rastit.

	<b>Pjesëmarrja në bashkëbisedim</b>	Nxënësi ndërhyr në mënyrë të përshtatshme në diskutime. Nxënësi fillon, vazhdon dhe përmbyll diskutimin në mënyrë efektive duke e marrë radhën aty kur duhet dhe në mënyrë të përshtatshme.
	<b>Zhvillimi i temës</b>	Nxënësi tregon ose përshkruan në mënyrë të qartë duke zgjeruar dhe mbështetur pikat kryesore më shpjegime dhe shembuj të detajuar.
	<b>Koheranca</b>	Nxënësi përdor mjete të kufizuara lidhëse për të realizuar të folur të qartë dhe koherente.

### Aspektet cilësore të përdorimit të gjuhës së folur për nivelin B 2

	Gama/diapazoni	Saktësia	Rrjedhshmëria	Ndërveprimi	Koheranca/ lidhja logjike
<b>B 2</b>	Zotëron mjaftueshëm fjalor për të qenë në gjendje të përshkruajë qartë, të shprehë pikëpamjet mbi tema të përgjithshme duke mos pasur nevojë të kërkojë përfjalë dhe duke	Tregon shkallë relativisht të lartë kontrolli. Nuk bën gabime që çojnë në keqkuptime dhe korrigjon shumicën e gabimeve të tij/saj.	Flet për një kohë të gjatë me një temp të njëtrajtshëm megjithëse ndonjëherë heziton duke kërkuar përfshirje dhe modele fjalish duke krijuar pauza të dukshme.	Mund të fillojë një diskutim, të ndërhyjë kur është e përshtatshme dhe të përfundojë diskutimin kur ai/ajo e shikon të nevojshme. Mund të shprehë konfirmim me të tjera, t'i ftojë ata për të marrë pjesë në diskutim etj.	Mund të përdorë një numër të kufizuar të mjeteve lidhëse për ta bërë të folurën e tij/saj të qartë dhe koherente.

përdorur forma të përbëra fjalish.				
------------------------------------	--	--	--	--

Për përbushjen e kompetencave të lëndës të cilat çojnë natyrshëm në forcimin e kompetencave kyçë, nxënësit i duhet të konsolidojë njohuritë dhe konceptet e duhura, të aftësohet në shkathësitë e fituara dhe të mbajë qëndrime dhe të zhvillojë vlera në situata të ndryshme.

## Njohuri dhe koncepte

### 1. Formimi kulturor:

- a. **Jeta e përditshme** (*organizimi i një plani ditor dhe i kohës së studimit; kujtime të mrekullueshme; dita më e bukur e jetës sime; qëllimet afatshkurtër dhe afatgjatë; çfarë dua unë për të ardhmen time; etj.*).
- b. **Bota e shkollës dhe e punës** (*organizimi i një biznesi të vogël; shqetësimet e shoqërisë së sotme si papunësia etj; studimet dhe universitetet në vend dhe në botë, etj.*).
- c. **Jeta personale dhe shoqërore** (*shanse dhe të drejta të barabarta për gratë dhe burra; të rinjtë dhe të rriturit; vendlindja; personalitetet në shoqëro; ngjarjet aktuale; etj.*).
- d. **Bota rreth nesh** (*arti në shekuj; e ardhmja; flora dhe fauna; historia e filmit; programet televizive; zakonet dhe traditat në vendet ku flitet gjuha që po mësohet; momente të rëndësishme të historisë botëror; personalitetet në fusha të ndryshme të jetës; etj.*).
- e. **Bota e komunikimit** (*bota e teknologjisë; rrjetet sociale; të shkruarit e letrave- letër kërkesë; letër ankesë; letër biznesi; ese.*).

### 2. Formimi gjuhësor:

- a. **Gramatika** (*ndajfoljet e mënyrë;, kohës, etj.; mbiemrat dhe strukturat e tyre; fjalitë e përbëra ;format e përbëra të foljeve në kohë të tashme, të shkuar dhe të ardhme; ligjërata e drejtë dhe e zhdrojtë në format e përbëra të foljeve; mënyra jo veporre në format e përbëra të foljeve; foljet modale; fjalitë kushtore, nyjet, emrat, inversioni, etj.*).

**b. Funksionet gjuhësore** (*dhënia e këshillave; të shprehurit e keqardhjes; theksimi i informacionit; të shprehurit e mendimin ose opinionit personal; vënia në diskutim ose të mos biesh dakord me dikë; sugjerime, ftesa, manipulimi, supozimi etj.*).

### Aftësi dhe shkathtësi:

#### Të dëgjuarit

##### Përshkrimi :

Nxënësi kupton gjuhën e folur standarde, kur flitet ose transmetohet në media, rrëth temave të njohura ose jo për të në jetën e përditshme shoqërore, akademike ose profesionale duke përfshirë edhe diskutime teknike. Nxënësi ndjek linjën e argumentit në një fjalim të gjatë dhe kompleks kur tema është e njohur për të.

##### Nxënësi:

- kupton në detaje çfarë thuhet në gjuhën e folur standarde edhe në ambiente të zhurmshme;
- ndjek një leksion, kur tema është e njohur dhe prezantimi është i strukturuar në mënyrë të hapur dhe të qartë;
- kupton pjesën më të madhe të dokumentarëve në radio që përcillen në gjuhën e përditshme dhe mund të identifikojë gjendjen shpirtërore dhe tonin e folësit, etj.;
- kupton dokumentarët televizivë, intervistat direkt, diskutimet, dramat dhe pjesën më të madhe të filmave në një dialekt standard;
- kupton idetë kryesore të një bisede të ndërlikuar, qoftë me tema abstrakte apo konkrete që përcillen në një dialekt standard duke përfshirë diskutimet teknike në fushën e tij të dijeve dhe interesit;
- kupton regjistrime në një dialekt standard rrëth temave të jetës së përditshme shoqërore, akademike ose profesionale dhe identifikon pikëpamjet dhe qëndrimet e folësit;
- përdor një varg strategjish për të arritur të kuptojë çështjet kryesore në një pjesë që dëgjon duke përdorur të dhënat nga konteksti.

## Të lexuarit

### Përshkrimi:

Nxënësi lexon në mënyrë të pavarur duke e përshtatur stilin dhe shpejtësinë e të lexuarit sipas llojit të tekstit dhe qëllimeve të tij duke përzgjedhur burime reference të përshtatshme. Nxënësi ka fjalor aktiv të gjerë por mund të ketë vështirësi me shprehjet idiomatike që hasen rrallë.

### Nxënësi:

- kupton menjëherë përbajtjen dhe rëndësinë e lajmeve, artikujve dhe raporteve mbi temat brenda interesit të tij duke treguar vërtetë interes;
- nxjerr informacion, ide, opinione nga burime shumë të specializuara brenda fushës së tij të interesit;
- kupton artikuj të specializuar që janë edhe jashtë fushës së tij të interesit duke përdorur fjalorin për të konfirmuar interpretimin e tij të terminologjisë;
- lexon dhe kupton artikuj dhe raporte rreth problemeve aktuale në të cilat autori shpreh qëndrime dhe pikëpamje të caktuara;
- kupton në detaje tekste brenda fushës së interesit ose zonës së specialitetit të tij profesional ose akademik;
- kupton artikuj të specializuar jashtë fushës së tij akademike apo profesionale duke përdorur fjalorin nëse është e nevojshme;
- kupton përbledhje që kanë të bëjnë me tema kulturore si filma, shfaqje teatrale, libra dhe koncerte duke treguar çështje e tyre më kryesore;
- lexon letra rreth temave brenda fushave të tij të interesit profesional apo personal duke kap çështjet më të rëndësishme;

- shqyrton shpejt një manual udhëzues (p.sh. për një program kompjuteri), gjen dhe kupton shpjegime dhe këshilla referuese për një problem të caktuar;
- kupton në një prozë apo dramë motivet për veprimet e personazheve dhe si ndikojnë ato për zhvillimin e subjektit.

## Të folurit

### Të folurit ndërveprues:

#### Përshkrimi:

Nxënësi flet rrjedhshëm dhe spontanisht pothuajse pa asnjë vështirësi për tema të përgjithshme nga fusha akademike, e punësimit, kohës së lirë duke e bërë të qartë lidhjen midis ideve të tij; komunikon në mënyrë spontane dhe përdor forma të rregullta gramatikore pa e kufizuar veten në atë se çfarë po thotë duke u përshtatur mirë me situatën në të cilën ndodhet.

#### Nxënësi:

- nis ose mbështet një bisedë të përgatitur ose intervistë;
- pyet nëse bashkëfolësi është i qartë dhe improvizon pyetje mbi tema interesante që mund të dalin gjatë një interviste;
- merr pjesë natyrshëm në një bisedë apo debat mbi një temë të përgjithshme;
- shkëmben informacion të detajuar faktik në fushën e tij të interesit;
- komenton opinionet e të tjera duke nxjerrë në pah avantazhet dhe dizavantazhet e pikëpamjeve të tyre;
- merr pjesë në një diskutim dhe mbështet mendimin dhe pikëpamjet e tija duke komentuar dhe argumentuar;
- transmeton shkallë të ndryshme të emocionit dhe thekson rëndësinë e përvojave apo ngjarjeve;
- shpreh saktë idetë dhe opinionet e tij; prezanton dhe përgjigjet në mënyrë bindëse ndaj argumenteve kompleks;
- përdor të folurën bindëse gjatë një bisede duke treguar qartë deri ku mund të bëjë lëshime;

- kupton dhe shkëmbin informacione dhe këshilla komplekse në çështje që lidhen me fushën e tij të interesit;
- zhvillon rrjedhshëm dhe në mënyrë efektive një intervistë ku mund të shkëputet nga pyetjet e parapërgatitura dhe duke krijuar replika interesante.

#### **Produkti i të folurit:**

##### **Përshkrimi:**

Nxënësi bën përshkrime dhe prezantime të qarta dhe të zhvilluara në mënyrë sistematike duke vënë në dukje çështjet më kryesore dhe duke i mbështetur ato me detaje dhe shpjegime të përshtatshme.

##### **Nxënësi:**

- jep përshkrime të qarta dhe të hollësishme mbi subjekte të ndryshme që lidhen me fushat e interesit;
- kupton dhe përbledh gojarisht tekste të shkurtra të shkëputura nga mësimet e reja, intervista apo dokumentarë që përmbajnë opinione, argument dhe diskutime;
- kupton dhe përbledh gojarisht subjektin letrar dhe vazhdimësinë e ngjarjeve në një pjesë të shkëputur nga një film ose teatër;
- shpjegon një pikëpamje mbi një çështje kryesore duke dhënë avantazhet dhe dizavantazhet e zgjedhjeve të ndryshme;
- bën lajmërimë qartë, rrjedhshëm dhe në mënyrë spontane për tema të përgjithshme;
- jep një sërë argumentesh të parashtuara mirë duke lidhur idetë e tija në mënyrë logjike;
- hamendëson rreth shkaqeve, pasojave dhe situatave të supozuara;
- zhvillon një argument në mënyrë sistematike duke prezantuar çështjen kryesore dhe faktet që e mbështesin atë;

- bën një prezantim të qartë dhe të zhvilluar në mënyrë sistematike dhe mund të shkëputet natyrshëm nga materiali i përgatitur nëse ja kërkon audiencia.

## Të shkruarit

### Përshkrimi:

Nxënësi shkruan tekste të qartë dhe të detajuar për tema të ndryshme që lidhen me fushën e tij të interesit duke vlerësuar dhe përmbledhur informacionin dhe argumente të marra nga burime të ndryshme. Nxënësi gjithashtu shpreh në mënyrë efektive pikëpamjet e tij me shkrim.

### Nxënësi:

- shkruan përshkrime të qarta dhe të detajuara të ngjarjeve dhe përvojave reale ose të imaginuara dhe respekton të gjitha rregullat e zhanrit në të cilin shkruan;
- vlerëson idetë ose zgjidhjet e ndryshme të një problemi;
- shkruan ese ose raport dhe zhvillon argumentin në mënyrë sistematike me idetë kryesore dhe detajet mbështetës;
- përmbledh informacion dhe argument nga media si dhe nga burime të ndryshme;
- trajton tema në një ese ose “letër një botuesi” duke dhënë arsyen pro ose kundër një pikëpamjeje të caktuar;
- shtjellon një argument në një ese ose raport duke nxjerrë në pah problemet kryesore dhe duke përfshirë edhe detajet mbështetëse;

- shkruan rreth ngjarjeve ose përvojave të vërteta ose të sajaura në një mënyrë të detajuar dhe të thjeshtë për t'u lexuar;
- shkruan një artikull kritik për një film ose libër;
- shpreh ndjenja dhe qëndrime në një letër personale;
- raporton për të rejat e ditës duke bërë të qartë aspektet më të rëndësishme sipas mendimit tim për një ngjarje.

## Vlera dhe qëndrime

### Nxënësi:

- demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;
- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup;
- tregon gatishmëri për të bashkëpunuar;
- ndjek më vëmendje shokët kur flasin dhe respekton radhën e të folurit;
- përzgjedh fjalorin e duhur (nuk fyen, përdor fjalët e mirësjelljes, etj.);
- tregon interes në materialet që lexon;
- respekton bashkëfolësit pa dallime gjinie, besimi, ideje;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup;
- demonstron bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe në diskutime;

- vlerëson burime të ndryshme informacioni;
- mban qëndrimin e tij ndaj problemeve që dalin në klasë dhe në shkollë;
- është i paanshëm në marrjen e vendimeve.

Për të kryer detyrat që i jepen nxënësi duhet të përfshihet në veprimtari të shumta gjuhësore dhe të përdorë strategji komunikuese. Strategjitetë konsiderohen si nyje lidhëse midis burimeve të nxënësit (kompetencat) dhe se çfarë ai mund të bëjë me ato (veprimtaritë komunikuese). Shumica e situatave përfshijnë llojshmëri veprimtarish dhe përdorim të më shumë se një aftësie ose shkathtësie. Për shembull në një orë mësimi , një nxënësi i kërkohet të dëgjojë shpjegimin e mësuesit, të lexojë një tekst me zë ose në heshtje, të ndërveprojë me nxënësit e tjerë në grup, të shkruajë një ushtrim ose ese madje edhe të perifrazojë, shpjegojë etj. Strategjitetë janë mjeti që nxënësi përdor për të mobilizuar dhe balancuar të gjitha burimet e tij, të aktivizojë të gjitha aftësitë e tij për të përbushur plotësisht dhe me sukses detyrat që i jepen.

<b>Strategjitetë që përdor nxënësi në veprimtaritë prodhuese (produkti i të folurit/ produkti i të shkruarit)</b>	
Planifikimi	Planifikon atë që do të thotë dhe mënyrat se si do ta shprehë duke konsideruar edhe efektin që do ketë tek marrësi i informacionit.
Kompensimi	Perifrazon për të plotësuar mangësitë që mund të ketë në fjalor ose strukturë fjalish.
Monitorimi dhe korrigimi	Korrigjon gabimet kur kuption se këto gabime kanë çuar në keqkuptime. Liston gabimet që bën më dendur dhe i monitoron ato gjatë të folurit ose të shkruarit.
<b>Strategjitetë që përdor nxënësi në veprimtaritë marrëse (të kuptuarit gjatë të dëgjuarit dhe të lexuarit)</b>	
Identifikimi i të dhënave ndihmëse dhe gjetja e kuptimit	Përdor strategji të shumta për të kuptuar plotësisht duke përfshirë të dëgjuarin për idenë kryesore, të kuptuarin duke përdorur të dhënat e kontekstit.

Strategjitet që përdor nxënësi në veprimtaritë ndërvepruese (të folurit ndërveprues/ të shkruarit ndërveprues)	
Marrja e fjalës në bashkëbisedim	Ndërhyr në një diskutim në mënyrë të përshtatshme duke përdorur shprehjet e duhura gjuhësore. Fillon, vazhdon dhe përfundon diskutimin në mënyrë të përshtatshme. Fillon bisedën, merr fjalën në momentin e duhur dhe e përfundon bisedën kur e shikon të nevojshme. Përdor shprehje si “kjo është pyetje e vështirë për tu përgjigjur” për të fituar kohë kur nuk gjen fjalën e duhur për të vazhduar.
Bashkëpunimi	Bën komente dhe ndjek linjën e diskutimit duke ndihmuar në vazhdimesinë e tij. Konfirmon që kuption dhe fton të tjerët të marrin pjesë në diskutim.
Pyetje për t'u qartësuar	Pyet për të parë nëse ka kuptuar çfarë po thuhet dhe kërkon sqarime për informacion tē pa qartë.

## 2.8 Ndarja e orëve mësimore

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për klasën e XII (gjuha e huaj e parë), sipas orëve vjetore të përcaktuara në Planin Mësimor të Arsimit të Mesëm të orientuar (gjuhët e huaja).

**Orët Mësimore    34 javë x 4 orë/javë = 136 orë vjetore**

<b>Klasa e XII</b>	<b>Formimi kulturor</b>	<b>Formimi gjuhësor</b>		<b>Puna me portofolin</b>	<b>Totali i orëve</b>
		<b>Gramatika</b>	<b>Funksionet gjuhësore</b>		
					<b>136 orë</b>

				<b>Portofoli Evropian Gjuhëve</b>	i
	<b>40%</b>	<b>30%</b>	<b>20%</b>	<b>10%</b>	
	<b>54 orë</b>	<b>41 orë</b>	<b>27 orë</b>	<b>14 orë</b>	

Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10% të orëve të përcaktuara në tabelë duke pasur parasysh karakteristikat e çdo klase si edhe përparimin e nxënësve.

Tek orët e formimit kulturor përfshihen pjesët e reja të leximit dhe të dëgjimit të cilat përfshijnë njohuritë që merr nxënësi mbi botën e punës, shkollës, jetës personale, natyrës, udhëtimet, kulturat dhe traditat e vendeve të ndryshme etj. Nëse mësuesi vë re se disa njohuri nuk mund të përvetësohen nga nxënësi brenda një ore mësimore, ai planifikon orë rimarrje për ato njohuri.

Orët e formimit gjuhësor mbi gramatikën përfshijnë njohuritë gramatikore dhe punën me fjalorin që realizohet gjatë vitit. Këtu mund të përfshihen edhe orët e përforcimit të njohurive nëse mësuesi e shikon të nevojshme. Gjithashtu njohuritë gramatikore nuk mund të merren jashtë kontekstit dhe duke pasur parasysh që përqasja në kurrikulën bërthamë është të mësuarit nëpërmjet situatave të të nxënësit, këto njohuri mund të ndërthuren edhe gjatë orëve kur fokusi është të folurit ose të shkruarit.

Funkcionet gjuhësore ju referohen akteve të komunikimit që nxënësi realizon gjatë procesit të marrjes së gjuhës së huaj dhe mund të realizohen në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e tjera.

Në klasën e 12 mësuesi duhet të planifikojë në fund të vitit shkollor orë për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar të gjuhës së huaj. Këto orë mund të merren si nga orët e formimit kulturor ashtu edhe nga orët e formimit gjuhësor.

Vlerësimi i nxënësit bëhet i mbështetur edhe në punët e tij të portofolit. Si rezultat del domosdoshmëri që mësuesi të planifikojë orë edhe për realizimin e projekteve dhe punëve të portofolit.

Teste të detyruara gjatë një viti shkollor janë 3 (tri) të cilat kryhen rrëth përfundimit të çdo periudhe.

Planifikimi i orëve mësimore bëhet vjetor (sintetik- bëhet ndarja totalë e orëve) si edhe në bazë periudhash tre mujore (analistik- trajtohen temat për çdo orë mësimi).

### **3 UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre shërben për zhvillimin gjuhësor të nxënësve dhe konsolidimin e kompetencave kyçë dhe ato të lëndës.

Mësuesit duhet të përditësojnë njojuritë rrëth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësi dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicjen për të qenë i suksesshëm dhe aktiv në jetën e përditshme dhe botën e punës. Metoda, strategji dhe teknika të tillë si: diskutim për njojuritë paraprake, diagram piramidale, lexim i drejtuar, imaginata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditarët e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen, puna në çift ose në grup etj., shërbejnë si nxitje për nxënësin dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Përqasja ndaj metodologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies duhet të jetë shumë e gjerë dhe të paraqesë të gjitha mundësitetë në mënyrë të qartë dhe transparente duke shmangur dogmatizmin. Mësuesi duhet të përdorë ato metoda që e ndihmojnë atë më shumë të arrijë përmbytjen e qëllimit final që është plotësimi i nevojave të nxënësit për t'u bërë një zotëruesh i mirë i gjuhës.

Mësimdhënia e gjuhës së huaj karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

#### **Mësimdhënie me në qendër nxënësin**

Nxënësi është në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësit. Nxënësit e një klase nxënës në mënyra të ndryshme: disa individualisht ose në grup, të tjera nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarrur ose me anë të mjeteve të ndryshme didaktike. Përpos kësaj, lënda e gjuhës së huaj kërkon që nxënësi të nxërë konceptet, të zotërojë shprehitë dhe të zbatojë njojuritë

gjuhësore. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxëninit dhe nevojat e nxënësit. Qëllimi i çdo strategje të mësimdhënies është që çdo nxënës të mësojë dhe të zbatojë njojuritë gjuhësore në mënyrë efektive.

### **Të mësuarit bashkëveprues**

Mësuesit sigurojnë një mjeshtës pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarin bashkëveprues. Nxënësi gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh motivohet të punojnë më nxënësit e tjerë. Detyrat e përbashkëta i sigurojnë nxënësit më shumë kohë për të komunikuar dhe për të ndarë përvojat e tij me pjesëtarët e tjerë të grupit. Puna në grupe nxit respektin dhe tolerancën ndaj mendimit të tjetrit si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për ndarjen e përgjegjësive dhe punës.

Njëherazi edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet duke forcuar më shumë lidhjen midis kompetencave kyçë dhe atyre të lëndës.

### **Integrimi**

Veprimtaritë gjuhësore si: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe përdorimi i drejtë i gjuhës trajtohen në mënyrë të integruar që të sigurohen lidhje kuqtimplota mes tyre. Ato plotësojnë njëra- tjetrën dhe zhvillohen së bashku për ta bërë nxënësin të aftë të komunikojë dhe të përdorë njojuritë e marra në situate të njobura dhe të panjobura për të dhe të zhvillojë aftësitë e tij të të lexuarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të shkruarit.

### **Procesi i rimarrjes së njojurive**

Aftësitë dhe shkathtësitë, njojuritë rreth sistemit gjuhësor dhe llojet e ndryshme të teksteve zhvillohen duke u rishikuar çdo vit. Kjo arrihet duke kaluar nga e njobura tek e panjobura dhe nga më e thjeshta te më e vështira. Temat dhe njojuritë do të rimerren në mënyrë të hollësishme dhe ciklike në fazë të njëpasnjëshme të programit mësimor. Kjo mundëson që nxënësi të përparojë nga niveli bazë në nivele më të larta të përdorimit të gjuhës.

### **Situata e të nxëninit**

Mësuesi duhet të parashikojë situatë të nxëni që të realizojë gjatë një ose disa temave mësimore. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njojurive nëpërmjet një situate praktike ose reale. Kjo mund të zgjasë një ose disa orë mësimi. Këto situata ndihmojnë që nxënësi t'i përdorë njojuritë e marra në jetën e tij të përditshme pa vështirësi dhe në interes të tij.

Pavarësisht metodave të përdorura mësuesi duhet të ketë parasysh që nxënësi ka fituar:

- kompetencat e duhura;
- aftësinë për t'i përdorur këto kompetanca;
- aftësinë për të përdorur strategjitet e duhura në vënien e kompetencave në veprim.

## 4 UDHEZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi i nxënësit është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencash. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënëtit, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësit (njohuri, shkathësi, qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve.

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënëtit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e fortë të nxënësit në përmbushjen e kompetencave kyçë dhe ato të programit të lëndor për secilën klasë, si dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e programeve.

Në përgjedhjen e praktikave të vlerësimit, përcaktimin e kohës së përshtatshme për vlerësim dhe përgjedhjen e materialeve që do të vlerësohen duhet pasur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përgjedhja e veprimitarive që mundësojnë demonstrimin e formimit dhe konsolidimit të kompetencave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë di aktualisht nxënësi;
- besimi se të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet e tyre.

Tradicionalisht, tre koncepte konsiderohen nga më themelorët në vlerësim: vlefshmëria, besueshmëria dhe të qenit vlerësim i realizueshëm. Mësuesi duhet të ketë parasysh që në vlerësim të jetë i paanshëm dhe transparent.

Vlerësimi i nxënësit ndahet në tre tipa kryesore:

**Vlerësimi diagnostikues** që zakonisht kryhet në fillim të vtit shkollor ose para zhvillimit të një grupei orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që ka nxënësi rrëth asaj për të cilën do të zhvillohet mësimdhënia gjatë vtit shkollor. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikat e mësimdhënieve dhe mësimnxënies në mënyrë që të përcaktohen strategjitet e të ardhmes. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

**Vlerësimi formues** ose i vazhdueshëm është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit, prindërit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënieve dhe të nxënësit. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit. Ky vlerësim mund të jetë edhe me simbole, komente etj.

**Vlerësimi përbledhës** ose përfundimtar kryhet më shpesh në fund të një grupei orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar pas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e fëmijëve të tyre, por edhe për të përmirësuar praktikat e mësimdhënieve dhe të nxënësit si dhe për të krahasuar arritjet me rezultatet e pritshme të të nxënësit.

Gjatë zbatimit të programit nxënësit duhet t'i jepet mundësia të punojnë individualisht, në çift ose në grup për kryerjen e detyrave të dhëna dhe përbushjen e kompetencave të lëndës dhe atyre kyçë. Në çdo rast mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënës, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësit në çdo orë mësimi dhe të vendosë nota në regjistër për secilën prej tyre. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rrëth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe mirë kryerjes së detyrave në klasë dhe jashtë klase.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Këto vlerësime bëhen në mënyrë të alternuar me njëri-tjetrin për t'i dhënë mundësi mësuesit të bëjë një vlerësim të saktë dhe të mirëpeshuar për të gjitha veprimtaritë gjuhësore. Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së të nxënësit dhe mësimdhënieve.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësi. Praktikat e reja sot orientojnë vendosjen e kritereve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësi. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësit për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi dhe deri tek rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve: ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjeter formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

**Vetëvlerësimi** është element i rëndësishëm në të mësuarin e gjuhës së huaj. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e nxënësit në vazhdimësi. Gjatë vetëvlerësimit në procesin mësimor ndiqen këta hapa:

- mësuesi diskuton me nxënësit atë që ata do të arrijnë në klasë;
- nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte dhe më pas mësuesi dhe nxënësi bëjnë komentin përfundimtar;
- nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe duke marrë role te ndryshme, madje ndonjëherë dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit;
- nxënësi mban shënim arritjet e tij në PEGJ duke përdorur edhe gjuhën amtare;
- mësuesi bisedon me nxënësit individualisht dhe i tregon arritjet;
- nxënësi cakton objektivat për të ardhmen.

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Njohja e nxënësit me vetëvlerësimin e ndërgjegjëson atë të kuptojë më mirë problemet e të mësuarit dhe i jep mundësi të caktojë objektiva për të ardhmen.

Vetëvlerësimi realizohet gjatë punës me Portofolin Evropian të Gjuhëve (PEGJ).

### **Vlerësimi me portofol lëndor (Portofoli Evropian i Gjuhëve)**

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor, kontributave dhe arritjeve të tij në gjuhën që po mëson, për punën individuale dhe në grup, krijimtarinë, talentin, si dhe për aspekte të gjykimit dhe reflektimit të nxënësit për veten dhe të tjeterët.

Portofoli Evropian i Gjuhëve ka dy funksione: a. raportues dhe b. pedagogjik

Ai përbëhet nga tri pjesë:

- a. **Pasaporta gjuhësore** ku nxënësi regjistron nivelet gjuhësore, kualifikimet dhe përvojat ndërkulturore.
- b. **Biografia gjuhësore** ndihmon nxënësin të regjistrojë dhe të reflektojë mbi progresin e tij gjuhësor.
- c. **Dosja** e cila mund të përmbarë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndërlendore, certifikata, diploma, etj..

Për informacion të mëtejshëm mbi vlerësimin mësuesi i referohet udhëzimeve përkatëse.